

V E N D I M
Nr. 2, datë 06.12.2017
I
ORTAKUT TË SHOQËRISË
"AGI KONS" SHPK

Në mbështetje të nenit 135, pika 2, gërma "ë", dhe nenet 177, 178 të Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", sot, datë 06.12.2017, u mbledh Asambleja e Ortakut të vetëm të shoqërisë AGI KONS Shpk, në Selinë e Shoqërisë në Rrugën "Rezidenca Kodra e Diellit" Selitë, Komuna Farkë, Tiranë, Shqipëri në prezencën e ortakut:

- Z.Elvis Sula, zotërues i kuotës, që përbën 100% të kapitalit themeltar të shoqërisë, i datëlindjes 29/09/1977 me Numër Personal H70929121H, lindur në Tiranë, banues në Tiranë.

Rendi i Ditës

1. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit të Audituesit Ligjor për zmadhimin e kapitalit të Shoqërisë me anë të fitimeve të mbyllura në vitin 2016 për shumën 1.500.000.000 (një miliard e pesëqind milion) lekë;
2. Shqyrtimi dhe miratimi i ndryshimeve të statutit si rezultat i rritjes së kapitalit të shoqërisë.

Me Vendimin Nr.1 datë 20.11.2017 ortaku ka rënë dakord që të zmadhojë kapitalin e Shoqërisë, me shumën 1.500.000.000 (një miliard e pesëqind milion) lekë, nga fitimet e vitit të mbyllur më 31 dhjetor 2016 të shoqërisë.

Për këtë qëllim, Asambleja e Ortakut të vetëm të Shoqërisë ka rënë dakord për emerimin në cilësinë e audituesit ligjor për përgatitjen e raportit për rritjen e kapitalit të shoqërisë nga fitimet e mbartura , shoqërinë ILD-99 Audit sh.p.k shoqëri e audituese me partnerë angazhimi nga Z. Luan Kamberi, lindur më 23.02.1965, në Tepelenë, Shqipëri, banues në Rr. Mehdiar Shtylla, Tiranë, Shqipëri, mbajtës i licencës së Audituesit Ligjor Nr. 40, datë 13.01.2000.

Shoqëria ILD-99 Audit sh.p.k i ka paraqitur Asamblesë së Ortakut të vetëm të Shoqërisë Raportin për Rritjen e kapitalit të shoqërisë nga fitimet e vitit 2016 të shoqërisë dhe fitimet e mbartura dhe kapitali i shoqërisë nga 1,000,000 (një milion) lekë bëhet 1.501.000.000 (një miliard e pesëqind e një milion) lekë.

Të gjitha kërkesat për mbajtjen e një mbledhje të rregullt janë përmbushur në përputhje me Statutin e Shoqërisë dhe Ligjin "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregëtare".



PËR SA MË SIPËR, Asambleja Ortakut të vetëm të Shoqërisë **AGI KONS Sh.p.k.**

VENDOSI:

1. **Të miratojë** Raportin e Audituesit Ligjor ILD-99 Audit sh.p.k për zmadhimin e kapitalit të Shoqërisë AGI KONS Sh.p.k. në shumën 1.500.000.000 (një miliard e pesëqind milion) lekë, fitimet e mbartura të shoqërisë.
 - Pra kapitali i nënshkruar i shoqërisë nga 1,000,000 (një milion) lekë rritet dhe me 1.500.000.000 (një miliard e pesëqind milion) lekë bëhet 1.501.000.000 (një miliard e pesëqind e një milion) lekë.
 - Vlera nominale për kuotë mbas rritjes së kapitalit si më sipër bëhet 1.501.000.000 lekë/kuotë.
 - Numri i kuotave mbetet 1 kuotë.

2. **Të miratojnë** ndryshimet në Statutin e Shoqërisë në pjesën e kapitalit themeltar i cili riformulohet si më poshtë:
 - Kapitali themeltar i shoqërisë nga 1,000,000 (një milion) lekë rritet edhe me 1.500.000.000 (një miliard e pesëqind milion) lekë dhe bëhet 1.501.000.000 (një miliard e pesëqind e një milion) lekë.
 - Vlera nominale për kuotë mbas rritjes së kapitalit nga 1.000.000 lekë/kuotë, rritet me 1.500.000.000 lekë/kuotë dhe bëhet 1.501.000.000 lekë/kuotë.
 - Numri i kuotave mbetet 1 kuotë.
 - Zotërimi i kuotave është si vijon:
Ortaku Elvis Sula 1 kuotë (100% të kapitalit të Shoqërisë).

3. Asambleja e Ortakut autorizon Administratorin e Shoqërisë Z.Alban Çinari dhe në mungesë të tij çdo person të tretë të autorizuar prej tij, Depozitimin e këtij Vendimi në Regjistrin Tregtar, pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit, së bashku me të gjitha aktet e tjera shoqëruese.

Ky vendim hartohet në 4 (katër) kopje origjinale dhe nënshkruhet nga të pranishmit.


Asnjë vendim tjetër nuk u morr në këtë Mbledhje të Përgjithëshme të Asamblesë së Ortakut të vetëm të Shoqërisë.

ORTAKU I SHOQËRISË

Elvis SULA

Perfaqesuar me prokure

Gazmend METOHI



AGI KONS
SH.P.K.
TIRANE-ALBANIA

V E N D I M
Nr. 1, datë 20.11.2017

I
ORTAKUT TË SHOQËRISË
"AGI KONS" SHPK

Në mbështetje të nenit 135, pika 2, gërmat "dh" dhe "e" të Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", sot, datë 20.11.2017, në Selinë e Shoqërisë, në prezencën e ortakut:

- Z.Elvis Sula, zotërues i kuotës, që përbën 100% të kapitalit themeltar të shoqërisë, i datëlindjes 29/09/1977 me Numer Personal H70929121, lindur në Tiranë, banues në Tiranë.

RENDI I DITËS

1. Miratimin e Zmadhimit (Rritjes) të Kapitalit Themeltar të Shoqërisë "AGI KONS" SHPK;
2. Modalitetet e zmadhimit të kapitalit;
3. Emërimin e ekspertit kontabël të regjistruar për verifikimin e burimeve që do të përdoren për zmadhimin e kapitalit;
4. Autorizimin për kryerjen e formaliteteve të publikimit;
5. Të ndryshme dhe të mundshme.

Ortaku i vetëm i Shoqërisë "AGI KONS" SHPK, pasi shqyrtoi çështjen e rendit të ditës,

V E N D O S I:

Miratimin e Rendit të Ditës;

1. Zmadhimin e Kapitalit Themeltar të Shoqërisë "AGI KONS" SHPK nga shuma aktuale 1.000.000 Lekë në masën 1.501.000.000 Lekë.
2. Zmadhimi i Kapitalit të shoqërisë do të kryhet sipas modaliteteve që vijojnë:



- a. Kapitali themeltar zmadhohet nëpërmjet fitimeve të mbartura të shoqërisë në 31 dhjetor 2016.
 - b. Vlera nominale e çdo kuote do ndryshojë nga 1.000.000 lekë/kuotë në 1.501.000.000 lekë/kuotë.
3. Emëron Shoqërinë Ild-99 Audit Shpk, në cilësinë e ekspertit kontabël të regjistruar:
- a. të verifikojë vlerën nominale të ndryshuar për çdo kuotë për qëllim të rritjes së kapitalit sipas përcaktimeve të përmendura në këtë vendim;
 - b. të hartojë raportin përkatës dhe t'a paraqesë atë përpara Asamblesë së Përgjithshme.
4. Ortaku i vetëm i Shoqërisë autorizon Administratorin e Shoqërisë Z. Alban Çinari dhe në mungesë të tij çdo person të tretë të autorizuar prej tij,
- a. të ndjekë të gjitha procedurat ligjore të kërkuara nga legjislacioni shqiptar për realizimin e operacionit të zmadhimit të kapitalit themeltar të shoqërisë.
 - b. depozitimin e këtij Vendimi në Regjistrin Tregtar, pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, së bashku me të gjitha aktet e tjera shoqëruese.
5. Autorizohet, Zj/Z. Rajmonda Koka, i/e dtl.02/10/1977, mbajtës i letërnjoftimit Nr. 028510828, Nr. Personal: H76002139U, të ndërmarë dhe të ndjekë të gjitha hapat e duhura ligjorë për depozitimin e këtij vendimi pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit, deri në marrjen e ekstraktit përkatës që vërteton kryerjen e këtyre veprimeve për të cilat autorizohet;
6. Ky vendim hartohet në 4 (katër) kopje origjinale dhe nënshkruhet nga:

ORTAKU I SHOQËRISË

Elvis SULA

Perfaqesuar me prokure

Gazmend METOHU